

Formati i plotë i një standardi me grupet e propozuara të detyrave / funksioneve

Standardi i profesionit: Teknik i mesëm në bujqësi

Profesioni: **Teknik i mesëm në bujqësi**

Sektori: Bujqësi, blegtori, veterinar

Niveli ISCO: II, Kodi 6130

Përshkrimi i profesionit: Tekniku/ja i/e mesëm në bujqësi është një profesionist polivalent, i pajisur me aftësi të specializuara në fushën e agronomisë, teknologjive të prodhimit bimor e blegtoral, zbatimit të politikave bujqësore, përfshirë legjislacionin dhe rregulloret e sektorit të bujqësisë. Tekniku/ja i/e mesëm në bujqësi analizon, planifikon dhe organizon aktivitete në fushën dhe në përditshmërinë e vet. Ai/Ajo siguron dhe menaxhon burimet e nevojshme njerëzore, materiale dhe financiare dhe përgatit vendin e punës për kryerjen e detyrave. Ai/Ajo mbikëqyr procesin e përgatitjes së tokës për mbjelljen e bimëve të arave, perimeve (në fushë dhe mjedise të mbrojtura), kulturave foragjere, drufrutorëve, vreshtave, ullishtave dhe agrumeve, si dhe monitoron procesin e mbjelljes së tyre duke zbatuar masat e duhura agroteknike për kryerjen e shërbimeve të ndryshme. Ai/Ajo kryen vjeljen, klasifikimin, paketimin dhe ruajtjen e produkteve të prodhimit bujqësor.

Tekniku/ja i/e mesëm në bujqësi mbikëqyr dhe zbaton hallkat e teknologjisë së prodhimit biologjik (BIO).

Ai/Ajo mbikëqyr dhe zbaton hallkat e teknologjisë në prodhimin blegtoral, monitoron ushqyerjen dhe mbarështimin e kafshëve shtëpiake në përputhje me llojin dhe kategorinë e tyre duke siguruar higjienën e hapësirës së mbarështimit, kafshëve dhe pajisjeve.

Ai/Ajo mbikëqyr përdorimin dhe mirëmbajtjen e makinerive, pajisjeve dhe veglave të punës për punime bazë dhe plotësuese bujqësore dhe blegtorale.

Ai/Ajo mbikëqyr proceset e përpunimit (të thjeshtë) fillestar të prodhimit bujqësore dhe blegtoral duke prodhuar produkte të thjeshta ushqimore nga frutat, perimet dhe qumështi.

Ai/Ajo zbaton standardet teknike në fushën e prodhimit bujqësor dhe blegtoral.

Tekniku/ja i/e mesëm në bujqësi diskuton me kolegët, vartësit, eprorët dhe klientët duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët.

Ai/Ajo zbaton bazën ligjore që i referohet veprimtarive profesionale bujqësore, kryen detyra administrative dhe tregtare, zbaton rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit dhe përmbush standardet për garantimin e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve të kryera, si dhe përgatit dhe plotëson dokumentacionet e duhura.

Ai/ajo ngre nivelin profesional të tij duke u trajnuar vazhdimisht dhe përditësuar me teknologjitë e reja në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë.

Mjedisi i Punës dhe Kushtet e Punës: Për teknikun/en e mesëm në bujqësi, puna fillon në orën 08:00 dhe përfundon në orën 16:00 duke u bazuar në nenet e Kodit të Punës lidhur me kohëzgjatjen e punës dhe pushimeve. Kohëzgjatja ditore normale e punës është jo më shumë se 8 orë. Ajo përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, në kontratën kolektive ose në kontratën individuale të punës, brenda limiteve të kohës javore maksimale të punës (jo më shumë se 40 orë).

Orët e fillimit dhe të mbarimit të punës përcaktohen nga rregullorja e brendshme, brenda kufijve të parashikuara nga ligji. Punëdhënësi mund të kërkojë kryerjen e orëve shtesë të punës, por jo më shumë se 200 orë në vit.

Tekniku/ja i/e mesëm në bujqësi punon në mjedise të hapura, gjysmë të hapura dhe të mbyllura. Puna zhvillohet në një hapësirë që shpesh ndikohet nga faktorë të ndryshëm klimatikë, pluhur, zhurmë dhe faktorë të tjerë. Aktiviteti i tij kërkon forcë fizike, saktësi dhe korrektesë. Ai/ajo punon me orare pune të zgjatur në varësi të stinëve të vitit dhe organizimit të punës, por në përputhje me legjislacionin në fuqi

Marrëdhënia me profesionet e tjera: Profesia e Teknikit të mesëm në bujqësi është e lidhur ngushtë me profesionet e mëposhtme (ata kanë kompetenca të përbashkëta - të përgjithshme): Kultivues të varieteteve të përziera, Kultivues të perimeve dhe bimëve të arave, Kopshtarë, kultivues të kopshtarisë dhe fidanëve,

Profesia e Teknikut të mesëm në bujqësi lidhet edhe me profesionet e mëposhtme: Punëtorë të varieteteve të përziera dhe fermave blegtorale, Punëtorë të fermave blegtorale, Asistentë dhe teknikë veteriner, Rritës shpendësh, rritës bagëtish

Standardi i profesionit: teknik i mesëm në bujqësi

GRUPI I DETYRAVE / FUNKSIONEVE	DETYRAT KRYESORE	AKTIVITETET
I ANALIZIMI, PLANIFIKIMI DHE ORGANIZIMI I PUNËS	1.1 Analizon, planifikon dhe organizon aktivitete bujqësore dhe blegtorale	1.1.1 Analizon në kohë dhe me cilësi detyrën për planifikimin dhe organizimin e punës; 1.1.2 Planifikon veprimtarinë ditore, javore dhe mujore, bazuar në tregues dhe rezultate konkrete; 1.1.3 Planifikon në kohën e duhur ndërhyrjet përmirësuese në prodhimin bimor dhe blegtoral; 1.1.4 Konsultohet me eprorin për detyrën periodikisht; 1.1.5 Përcakton prioritetet e ditës sipas teknologjisë së kultivimit dhe nevojave; 1.1.6 Planifikon burimet e nevojshme materiale dhe njerëzore sipas planit periodik; 1.1.7 Organizon në mënyrë ergonomike vendin e punës; 1.1.8 Ndan detyrat e punës në fermë sipas sektorëve dhe përvojës së punës së burimeve njerëzore; 1.1.9 Përcakton radhën e kryerjes së detyrave sipas teknologjisë së kultivimit; 1.1.10 Koordinon punën me të tjerët, periodikisht; 1.1.11 Raporton për ecurinë e punës, periodikisht;
II PËRGATITJA E VENDIT TË PUNËS	2.1 Përgatit burime dhe vendit të punës për kryerjen e aktiviteteve bujqësore dhe blegtorale	2.1.1 Kryen përgatitjet e duhura personale për punë në përputhje me rregulloret e higjienës dhe të sigurimit teknik; 2.1.2 Përzgjedh dhe përgatit bazën materiale për fillimin e punës sipas proceseve dhe planifikimeve të punës; 2.1.3 Përzgjedh mjetet, veglat, pajisjet dhe makineritë e punës sipas proceseve dhe planifikimeve të punës; 2.1.4 Përgatit vendin e punës sipas proceseve të planifikuara; 2.1.5 Kontrollon funksionalitetin teknik të mjeteve, veglave, pajisjeve dhe makinerive të punës sipas manualeve përkatëse;

		2.1.6	Pastron vendin dhe mjetet e punës pas çdo procesi të punës;
		2.1.7	Kontrollon kushtet e punës në përputhje me rregullat e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë.
III DETYRAT OPERATIVE	3.1 Mbikëqyr dhe zbaton hallka të teknologjisë së prodhimit bimor	3.1.1	Merr instruksionet për punën vazhdimisht;
		3.1.2	Merr mostrat e tokës për analiza agropedologjike dhe agrokimike sipas teknikave përkatëse;
		3.1.3	Mbikëqyr përgatitjen e tokës për mbjelljen e kulturave bujqësore njëvjeçare (bimët e arave, perimet dhe kulturat foragjere) sipas teknikave dhe llojit të kulturave;
		3.1.4	Mbikëqyr përgatitjen e tokës për mbjelljen e kulturave bujqësore shumëvjeçare (drufrutorë, vreshta, ullishte, agrume) sipas teknikave dhe llojit të kulturave;
		3.1.5	Zbaton teknikat e plehërimit bazë të tokës sipas kulturave të ndryshme bujqësore;
		3.1.6	Mbikëqyr cilësinë e farave dhe fidanëve sipas standardeve përkatëse;
		3.1.7	Zbaton procedurat e duhura për mbrojtjen e tokës sipas teknikave përkatëse;
		3.1.8	Zbaton sistemin e qarkullimit bujqësor të bimëve sipas teknologjive përkatëse;
		3.1.9	Mbikëqyr procesin e mbjelljes me farë sipas teknologjive përkatëse;
		3.1.10	Mbikëqyr procesin e mbjelljes me fidanë në fushë dhe mjedise të mbrojtura sipas teknologjive përkatëse;
		3.1.11	Mbikëqyr procesin e ujitjes sipas teknologjisë së kulturave;
		3.1.12	Mbikëqyr plehërimin plotësues të bimëve sipas teknologjisë përkatëse;
		3.1.13	Mbikëqyr punimet plotësuese për shërbimin e bimëve sipas teknologjisë së kulturave;
		3.1.14	Mbikëqyr krasitjet në kulturat drufrutore, vreshta, ullishte dhe agrume sipas kalendarit vjetor dhe teknikave përkatëse;
		3.1.15	Mbikëqyr trajtimet fitosanitare të mbrojtjes së bimëve sipas protokollit dhe kalendarit vjetor;
		3.1.16	Mbikëqyr procesin e pjekjes të kulturave bujqësore sipas destinacionit;
		3.1.17	Mbikëqyr procedurën e vjeljes së kulturave frutore sipas teknikave përkatëse;
		3.1.18	Mbikëqyr procedurën e korrjes dhe kositjes së bimëve të arave sipas teknikave përkatëse;
		3.1.19	Mbikëqyr grumbullimin dhe ruajtjen e prodhimit bujqësor në magazina dhe pikat e grumbullimit sipas llojit të bimëve dhe metodave përkatëse të ruajtjes;
	3.2 Mbikëqyr dhe zbaton hallka të	3.2.1	Vlerëson cilësinë biologjike të tokës sipas teknikave përkatëse;
		3.2.2	Mbikëqyr përgatitjen e tokës duke ruajtur mjedisin mikrobiologjik të saj sipas

teknologjisë së prodhimit bimor biologjik (BIO)	teknikave përkatëse; 3.2.3 Përzgjedh fara dhe/apo fidanë me prejardhje organike sipas certifikatës së origjinës; 3.2.4 Mbikëqyr plehërimin organik të tokës sipas teknikave të kompostimit; 3.2.5 Mbikëqyr mbjelljen e farave dhe fidanëve sipas teknikave përkatëse; 3.2.6 Mbikëqyr zbatimin e shërbimeve agroteknike sipas parametrave të kultivimit të prodhimit BIO; 3.2.7 Mbikëqyr proceset e korrjes, kositjes dhe vjeljes së kulturave bujqësore BIO sipas teknikave përkatëse; 3.2.8 Zbaton hallkat teknologjike për prodhimin e ushqimit blegtoral BIO, sipas standardeve dhe kërkesave ligjore; 3.2.9 Zbaton normat teknike të mbarështimit dhe kujdesit shëndetësor të kafshëve dhe shpendëve sipas standardeve dhe kërkesave ligjore; 3.2.10 Zbaton normat teknike të prodhimeve blegtorale BIO, sipas standardeve dhe kërkesave ligjore; 3.2.11 Mbikëqyr kushtet e ruajtjes së prodhimit BIO sipas parametrave të kërkuar.
3.3 Mbikëqyr dhe zbaton hallka të teknologjisë së prodhimit blegtoral	3.3.1 Mbikëqyr përzgjedhjen e kafshëve të nevojshme për mbarështim sipas drejtimit ekonomik; 3.3.2 Mbikëqyr kontrollin e higjienës së mjedisit brenda dhe jashtë fermës sipas standardeve të kërkuara; 3.3.3 Mbikëqyr riprodhimin e tufës sipas kalendarit vjetor; 3.3.4 Vrojtton dhe raportoje sjelljen dhe gjendjen shëndetësore të kafshës; 3.3.5 Grupon dhe strehon kafshët sipas llojit dhe racës, gjinisë, moshës dhe gjendjes fiziologjike; 3.3.6 Zbaton teknikat e të ushqyerit të gjedhëve sipas nevojave dhe drejtimit ekonomik të fermës; 3.3.7 Zbaton teknikat e të ushqyerit të imtave (të leshta dhe të dhirta) sipas nevojave dhe drejtimit ekonomik të fermës; 3.3.8 Zbaton teknikat e të ushqyerit të derrit sipas nevojave dhe drejtimit ekonomik të fermës; 3.3.9 Zbaton teknikat e të ushqyerit të një thundrakëve sipas nevojave dhe drejtimit ekonomik të fermës; 3.3.10 Zbaton teknikat e të ushqyerit të shpendëve sipas nevojave dhe drejtimit ekonomik të fermës; 3.3.11 Kontrollon higjienën e ushqimeve sipas llojit dhe kategorisë së kafshëve;

	3.3.12 Kontrollon higjienën e mjeteve dhe impianteve të ujit dhe të ushqimit sipas standardeve të kërkuara; 3.3.13 Kujdeset për të ushqyerit e të porsalindurve sipas kërkesave teknike; 3.3.14 Mbikëqyr të ushqyerit e kafshës pas lindjes sipas nevojave; 3.3.15 Kujdeset për të ushqyerit e kafshës me patologji sipas nevojave dhe gjendjes shëndetësore; 3.3.16 Zbaton kalendarin e masave të përgjithshme profilaktike sipas llojit dhe kategorisë së kafshëve; 3.3.17 Mbikëqyr zbatimin e masave higjienike gjatë mjeljes sipas standardeve të kërkuara; 3.3.18 Mbikëqyr grumbullimin dhe magazinimin e vezëve; 3.3.19 Mbikëqyr grumbullimin dhe ruajtjen e prodhimit blegtoral; 3.3.20 Mbikëqyr zbatimin e masave për administrimin e mbetjeve të fermës bujqësore dhe blegtorale sipas kërkesave teknike përkatëse;
3.4 Përdor dhe mirëmban makineritë, pajisjet dhe veglat e punës për punime bazë dhe plotësuese bujqësore dhe blegtorale	3.4.1 Përzgjedh makineritë, pajisjet dhe veglat e punës për punimet bazë dhe plotësuese sipas proceseve të punës; 3.4.2 Mbikëqyr kontrollin e gjendjes së makinerive mjeteve dhe agregatëve të tyre, si dhe gatishmërinë e tyre sipas manualeve përkatëse; 3.4.3 Mbikëqyr pastrimin dhe mirëmbajtjen e makinerive, mjeteve dhe agregatëve bujqësore sipas manualeve përkatëse; 3.4.4 Mbikëqyr pastrimin dhe mirëmbajtjen e makinerive dhe pajisjeve blegtorale sipas manualeve përkatëse; 3.4.5 Mbikëqyr riparime të thjeshta të makinerive dhe pajisjeve bujqësore dhe blegtorale; 3.4.6 Kryen kolaudimin dhe regjistrimin e agregatëve sipas proceseve të punës dhe manualeve përkatëse.
3.5 Realizon dhe mbikëqyr proceset e përpunimit të thjeshtë të prodhimit bujqësore dhe blegtoral	3.5.1 Mbikëqyr pastrimin e produkte bujqësore dhe blegtorale nga papastërtitë dhe lëndët e huaja sipas teknikave përkatëse; 3.5.2 Përgatit lëndët e para për përpunime të thjeshta sipas llojit të produktit dhe metodave përkatëse; 3.5.3 Mbikëqyr përpunimin artizanal të produkteve bujqësore (reçel, komposto, fruta të thata, çarja, raki, etj..) sipas teknikave përkatëse; 3.5.4 Kontrollon vetitë organoleptike të qumështit sipas parametrave të kërkuara; 3.5.5 Mbikëqyr sterilizimin dhe pasterizimin e qumështit sipas teknikave dhe parametrave të kërkuara;

IV DETYRAT ADMINISTRATIVE		3.5.6 Mbikëqyr përpunimin e qumështit në nënprodukte të tij sipas parametrave të kërkuara; 3.5.7 Përzgjedh vezët sipas destinacionit të përdorimit; 3.5.8 Mbikëqyr ambalazhimin dhe etiketimin e produkteve përfundimtare.
	4.1 Kryen detyra administrative në fermë	4.1.1 Zbaton legjislacionin e punës dhe legjislacionin përkatës të fushës së bujqësisë; 4.1.2 Plotëson planin ditor, javor të punës sipas formateve të kërkuara; 4.1.3 Dokumenton punën e kryer dhe urdhrat e realizuara të punës sipas formateve të kërkuara; 4.1.4 Merr pjesë në përgatitjen e raporteve periodike të punës; 4.1.5 Regjistron të dhënat për faturat dhe ofertat e lëshuara në regjistrat përkatës në formë elektronike ose me shkrim; 4.1.6 Mbanë shënime, periodikisht, lidhur me konsumin e materialeve gjatë procesit të punës; 4.1.7 Ruan dhe arkivon dokumentacionin sipas formateve të kërkuara.
V DETYRAT TREGTARE	5.1 Kryen dhe ndjek detyra tregtare në fermë	5.1.1. Zbaton legjislacionin tatimor; 5.1.2. Kontrollon tregun e materialit lidhur me çmimet dhe cilësinë e tyre; 5.1.3. Kryen llogaritje të kostove të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale bazuar në të dhënat e tregut; . 5.1.4. Përgatit oferta për produktet bujqësore dhe blegtorale; 5.1.5. Kryen blerje të input-ve bujqësore, materialeve, mjeteve, veglave dhe pajisjeve të punës të nevojshme; 5.1.6. Llogarit çmimin përfundimtar produktet e ofruara; 5.1.7. Regjistron të dhënat për faturat e lëshuara ndaj klientëve; 5.1.8. Zbaton teknika të marketingut për produktet që ofron.
VI KOMUNIKIMI DHE BASHKËPUNIMI ME TË TJERËT	6.1 Komunikon me eprorët, bashkëpunëtorët, klientët dhe institucionet përkatëse dhe ngre	6.1.1 Merr informacion të vazhdueshëm mbi problemet dhe të rejat e ditës; 6.1.2 Zbaton drejt dhe saktë rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal; 6.1.3 Punon në grup duke zbatuar parimet e punës në grup në mënyrë korrekte; 6.1.4 Zbaton kodin e etikës dhe rregullat e hierarkisë profesionale në komunikimin me eprorët dhe kolegët; 6.1.5 Jep dhe merr udhëzime me bashkëpunëtorët për realizimin e detyrës së punës duke

	nivelin profesional	përdorur terminologji të qartë në komunikim; 6.1.6 Zbaton teknologjitë e reja për të arritur një komunikim të suksesshëm me të tjerët; 6.1.7 Zgjidh ankesat dhe mosmarrëveshjet, duke përdorur teknikat e duhura; 6.1.8 Vendos komunikim cilësor dhe transparent me eprorët, bashkëpunëtorët dhe institucionet përkatëse duke ndjekur rregullat e komunikimit të biznesit; 6.1.9 Vepron në përputhje me parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët; 6.1.1 Informon eprorin dhe klientët e tij/saj në lidhje aktivitetin e vet duke përdorur terminologji të qartë dhe profesionale; 6.1.2 Përcakton qartë nevojat specifike për trajnim të vazhdueshëm; 6.1.3 Identifikon teknologjitë bashkëkohore për proceset e punës; 6.1.4 Ndjek trajnimet dhe informon në kohë bashkëpunëtorët për aplikimin e teknikave të reja; 6.1.5 Merr pjesë në panaire dhe ekspozita;
VII SIGURIMI I CILËSISË	7.1 Siguron cilësinë e prodhimeve bujqësore në fermë	7.1.1. Kontrollon cilësinë duke zbatuar protokollet dhe teknikat e cilësisë të prodhimeve bujqësore; 7.1.2. Kontrollon cilësinë duke zbatuar protokollet dhe teknikat e cilësisë të prodhimeve blegtorale 7.1.3. Mbikëqyr seleksionimin e produkteve bujqësore sipas cilësisë 7.1.4. Mbikëqyr krijimin e kushteve të ruajtjes së produkteve bujqësore sipas parametrave të kërkuar, 7.1.5. Respekton normat dhe karencën e produkteve të mbrojtjes së bimëve sipas udhëzimeve përkatës, 7.1.6. Zbaton standardin HACCP 7.1.7. Zbaton standardin ISO dhe Global GAP 7.1.8. Mbikëqyrë trajtimin e ujit sipas destinacionit të përdorimit.
VIII MBROJTJA NË VENDIN E PUNËS DHE MBROJTJA E MJEDISIT	8.1 Zbaton procedurat dhe masat për sigurinë dhe shëndetin në	8.1.1. Zbaton rreptësisht Standardin kombëtar 18001 standardet dhe legjislacionin shqiptar për rregullat e sigurimit teknik; 8.1.2. Mbikëqyr përdorimin e produkteve desinfektuese, deratizuese dhe

punë	desinsektuese në stalla dhe mjedise të mbrojtura; 8.1.3. Zbaton teknikat e fiksimit të kafshëve; 8.1.4. Mbikëqyr përdorimin e produkteve fitosanitare në bujqësi; 8.1.5. Zbaton saktë manualët përkatëse në përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës; 8.1.6. Jep ndihmën e parë në rast aksidenti sipas procedurës; 8.1.7. Respekton sinjalistikën (udhëzimet e shkruara) në mjediset e punës sipas rregulloreve përkatëse; 8.1.8. Zbaton planin e evakuimit në raste emergjence sipas procedurës respektive; 8.1.9. Zbaton rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit sipas rregullores përkatëse; 8.1.10. Identifikon dhe raporton sipas rastit te personat përgjegjës për mosfunksionimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës; 8.1.11. Pastron dhe sistemon rregullisht vendin e punës para, gjatë dhe pas punës sipas llojit të punimeve;
8.2 Zbaton procedurat dhe masat për mbrojtjen e mjedisit	8.2.1. Zbaton rregullat e mbrojtjes së mjedisit dhe standardet ekologjike. 8.2.2. Zbaton rregulloret e ndarjes së mbeturinave sipas llojit para transportimit; 8.2.3. Ruan dhe depoziton mbetjet nga procesi i punës në përputhje me rregulloret e mjedisit. 8.2.4. Kryen aktivitete bujqësore dhe blegtorale duke përdorur energji dhe materiale në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit.